

LIGJ
Nr.8434, datë 21.12.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8283, DATË 3.2.1998 "PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 1998", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8418, DATË 28.10.1998

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 160 pika 1 dhe pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8283, datë 3.2.1998 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 1998", ndryshuar me ligjin nr.8418, datë 28.10.1998, në tabelën 2 "Investimet, sipas ministrive, për vitin 1998", grupi 11, titulli 11 Ministria e Arsimit dhe Shkencës kapitulli 6 shtohet dhe projekti "Tirana 2000".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.2277, datë 22.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani